



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA TROPOJE
SEKTORI I BURIMEVE NJERZORE

B.Curri, më 17.08.2018

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**Lloji i diplomës “ Shkenca juridike ose informatike ” niveli minimal i
diplomës “Master Profesional”**

Master profesional në fushën e shkencave Juridike ose informatike

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, Bashkia Tropojeshpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionet:

- 1 Specialist per Burimet Njerëzore ne Sektorin e Burimeve Njerëzore

– **kategoria IV-a.**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për të dy Proçedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

- Për lëvizjen paralele është 10 dit nga data e shpalljes në portalin e shërbimit kombëtar të punësimit
- Për Ngritjen në detyrë është 15 dit nga data e shpalljes në portalin e shërbimit kombëtar të punësimit

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- 1-Kryen punën specifike të sektorit ku bën pjesë, brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave;
- 2-Realizon detyrat në përputhje me politikat e institucionit, me standardet administrative, procedurat teknike, duke mbajtur parasysht praktikat më të mira profesionale;
- 3-Vepron në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës, dhe rregullat për konfidencialitetin në mbrojtjen e të dhënave personale;
- 4-Realizon punën e tij duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmerinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit;
- 5-Duhet të përditësojë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tij profesionale, në mënyrë që t'i përdore ato me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit;
- 6-Administrimin e dosjeve individuale që përmbajnë të dhënat individuale për çdo të punësuar dhe nëpunës civil si dhe çdo të dhënë tjetër lidhur me marrëdhëniet e punës si dhe të Regjistrit Qendror të Personelit;
- 7-Arkivimin e sigurtë dhe me metoda alternative të të dhënave të personelit dhe ruajtjen periodike të kopjeve të të dhënave në mjedis rezerve.
- 8-Është përgjegjës për strukturën e bazës së të dhënave dhe administrimin e saj.
- 9-Kujdeset për ruajtjen dhe konfidencialitetin e privilegjeve të aksesit në bazën e të dhënave elektronike të Regjistrit Qendror të Personelit.
- 10-Ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve ligjore mbi personelin dhe dokumentacionin.
- 11-Ndihmon në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë dhe hartimin e përshkrimeve të punës të punonjeseve në përputhje me pozicionin e punës.
- 12-Njoftimin e strukturave eprorë në rastet e konfliktit të interesit;
- 13-Hedh të dhënat për të gjithë punonjësit në regjistrin qendror të personelit (HRMIS) dhe PAV;
- 14-Plotëson regjistrin themeltar të punonjeseve dhe hedh të dhënat siç kërkohen në regjister për çdo punonjës në mënyrë manuale.
- 15-Harton inventarin e dosjeve për çdo punonjës dhe e bashkelidh inventarin dosjeve personale të secilit punonjës.
- 16-Plotëson kontratat për punonjësit e bashkisë dhe ndermarrjeve në vartësi sipas ligjit 7961 dt.12.07.1995 dt.12.07.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i arkivon dhe sistemon në dosjet e secilit punonjës.
- 17-Ben shpalljet në portalin e shërbimit kombëtar të punësimit, faqen zyrtare të institucionit, dhe këndin e njoftimeve të Bashkisë për rekrutimet e reja në shërbimin civil dhe të gjitha njoftimet e tjera që kanë të bëjnë me rekrutimin.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori, (sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar) (niveli i pagës VI-a),
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë vlerësimin e fundit pozitiv (mir apo shumë mire) të plotësuar nga institucioni në përputhje me VKM nr. 109 dt.26.2.2014 “Për vlerësimin e punës nëpunësive civil” i ndryshuar me VKM nr.252 dt.30.03.2016.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë minimum të nivelit “ Master Profesional” në degën Shkenca juridike ose informatike , edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.*(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 1 (një) vite,në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucione tregtare.Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
- c) Të njoh mirë programet e punës në kompjuter.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Tropoje, dokumentet si më poshtë:

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen në sekretarinë e Bashkisë Tropoje dorazi ose me postë, brenda datës 27.08.2018

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 29.08.2018, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkise Tropoje do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkise Tropoje nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- 3- Ligji nr. 44/2015 “Kodin e Procedurave Administrative ne Repupliken e Shqiperise”;
- 4-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;i ndryshuar dhe aktet nenligjore ne zbatim te tijë.
- 5-Ligjin nr. 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”.
- 6-Ligjin 9154 dt.6.11.2003 “Per arkivat ne Republikën e Shqipërisë”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedures së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të

Administratës Publike www.dap.gov.al. Në linkun: <http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Tropoje do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar të Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- Pranimit në shërbimin civil

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nepunesit civil”, i ndryshuar.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- d) Të jetë shtetas shqiptar;
- e) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- f) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- g) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- h) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- i) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- j) Të zotërojnë diplomë të nivelit “ Master Profesional” në degën Shkenca juridike ose informatike , edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.*(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- k) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 1 (një) vite,në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucione tregtare Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
- l) Të njoh mirë programet e punes ne kompjuter.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në sekertarin e Bashkis Tropoje , brenda dates 31.08.2018.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 10.09.2018,njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkise Tropoje do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me goj.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet

pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- 3- Ligji nr. 44/2015 “Kodin e Procedurave Administrative ne Repupliken e Shqiperise”;
- 4-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;i ndryshuar dhe aktet nenligjore ne zbatim te tijë.
- 5-Ligjin nr. 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”;
- 6- ligjin 9154 dt.6.11.2003 “Per arkivat ne Republikën e Shqiperise”

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al. në linkun:

<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njesia e menaxhimit burimeve njerzore Bashkise Tropoje do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

NJESIA E MENAXHIMIT BURIMEVE NJERZORE